ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA FERIZAJ

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**656-22-1432-1-2-1**
Nr i brendshëm	**656-22-31-121**

Sa i përket tenderit për

Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

AGRIBAU SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. LIDHJA E PEJES NR.136
(Adresa)

PRISHTINE
(Vendi) *(Kodi postar)* *10000*

044360324
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

LULZIM BERISHA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

agribau.ks@gmail.com
(Adresa elektronike)

19.04.2022
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. "AGRIBAU" PRISHTINE

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-B05 Njoftim per Kontrat - 04.03.2022
-Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje 24.03.2022 13:00
-Njoftim per vendimin e AK - 04.04.2022
-Qmimi me i ulet.
-Vendimi per pezullim te aktivitetit te prokurimit 07.04.2022
-Vendim per rishqyrtim te kerkeses 13.04.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

SH.P.K. "AGRIBAU" PRISHTINE

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

***Neni 1**- Qëllimi*
***Neni 6**- Ekonomiciteti dhe efikasiteti*
***Neni 7**- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*
***Neni 59**-Egzaminimi ,Vlersimi,dhe Krahasimi i Tenderve*
***Neni 60**-Kriteret per Dhenjen e Kontrates,*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me daten 04.04.2022 AK ka bere Njoftim te Vendimit per aktivitetin e prokurimit **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje, 656-22-1432-1-2-1** ku eshte shperblyer me kontrate OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.** në vlere prej 80,901.60 € dhe ka eliminuar kompanine tone "AGRIBAU" SHPK e cila kishte oferten me qmimin me te Ulët ne vlere prej 74,880.00 € .

Me daten 06.04.2022 ne kemi bere kerkese per Rishqyrtim te vendimit te lartcekur prane AK-se, ku me daten 07.04.2022 AK ka bere pezullim te aktivitetit te prokurimit.

Me daten 13.04.2022 AK ka marr Vendim me te cilin ka refuzuar kerkesen tone si te pa bazuar duke mos dhene asnje argument per te arsyetuar vendimin per refuzim.

Sipas zyres se Prokurimit ne jemi eliminuar me arsyetimin: **Nuk keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë, Ju nuk e keni plotësuar deklaratën nën betim ashtu siç është kërkuar në DT.**

Ne kemi Plotesuar te gjitha te dhenat e kerkuara ne deklaraten nen Betim ku ne rubriken per Identifikim te Operatorit Ekonomike, ne kemi plotesuar te gjitha rubrikat ku kerkohen te dhenat per identifikim; Emri i Kompanise, Adresa, Perfaqesuesi, Pozita, Neshkrimi, Data dhe Vula, dhe nuk qendron fakti se ne nuk kemi plotesuar ashtu siq kerkohet ne DT.

Pretendimi i AK-se se nuk eshte shkruar emri ne zbrastiren e hijezuar brenda tekstit ne te cilen edhe ashtu nuk ka pasur asnje shenje se duhet te shkruhet emri i kompanise, eshte nje arsyetim vetem me qellim te eliminimit te kompanise sepse rubrika e veqant ku kerkohet Identifikimi i OE-es eshte e plotesuar 100% nga ana jone, dhe mos shkruarja e emrit te OE-es ne ate hapsire brenda tekstit te deklarates nuk mund te konsiderohet si mosplotesim i drejt i deklarates.

Autoriteti Kontraktues do te duhej te kishte parasysh **Neni 59.4 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** ne te cilin thuhet;

> 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo

SH.P.K. "AGRIBAU" ABIS

devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Me daten 04.04.2022 ne kemi kerkuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik (KRPP) nje interpretim se; plotesimi i deklarates nga ana jone a mund te konsiderohet mosplotesim ne menyren e kerkuar i „Deklarates nen Betim'' dhe a mund te jete shkak per eliminim.
Me daten 13.04.2022 Experti i KRPP-se ka dhene nje sqarim lidhur me pyetjen e bere per interpretim, dhe ka sqaruar se në perputhje me nenin 47.19 te RRUOPP, **Neni 59.4 i LPP-se lejon Autoritetin Kontraktues qe te pranoj ofertat, ne raste te gabimeve ose paqartesive dhe ne raste te devijimeve te vogla. Ne te dyja rastet eshte nje kusht qe aspektet materiale te njoftimit per kontrate / dosjen e tenderit nuk janë prekur.**
Prandaj ne si OE Agribau SHPK konstatojme se deklarata nenBetim e plotesuar nga ana e jone perbushe **kushtin qe aspektet materiale te njoftimit per kontrate / dosjen e tenderit nuk janë prekur.** Deklarata eshte e plotesuar dhe permban te gjitha te dhenat e nevojshme dhe nuk shfaqe asnje devijim, nuk lene asnje hapsire per keqkuptim apo keq lexim dhe nuk bjen ne kundershtim me sqarimin e lartcekur te expertit te KRPP-se, dhe si e tille duhet te pranohet e plotesuar ne menyre te drejt.

AK me rastin e shperblimit me kontrate OE "Komtel Project Engineering" SH.P.K. ka bere shkelje te ligjit te LPP-se pikrisht **Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi,** ku thuhet se;
1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
OE i shperblyer me kontrate ka plotesuar deklaraten nen Betim ku ne pjesen e siperme ku eshte shkruar emri i AK- KOMUNA FERIZAJ (me tej Autoritet Kontraktues) ne vend te Autoriteti kontraktues e ka shkruar (me tej; **Komtel Project Engineering SH.P.K.)** dhe nese e marrim per baze vleresimin e AK si ne rastin tone se plotesimi yne i deklarates nen Betim nuk eshte plotesuar ashtu siq kerkohet ne DT i bjen se OE e shpallur per kontrate ka bere shkelje ne plotesim te deklarates, pasi qe ka paraqitur vehten si "me tej; Autoritet Kontraktues". (shih deklaratat nen Betim te OE-se se shperblyer me kontrate, te cilen i bashkangjesim kesaj ankese).
Prandaj AK nuk ka bere trajtim te barabart gjate procesit te ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te dokumentacionit, ku ka perdorur standarte te dyfishta ne te njejtin rast.

AK duke shperblyer me kontrate pa asnje arsyetim OE „Komtel Project Engineering'' SH.P.K. e cila ishte me qmim me te lart ne vlere prej 6,021.60 euro ka bere shkelje te ligjit te LPP-se Neni 6.1 **Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Pas gjitha ketyre fakteve te ofruara shpresojm dhe besojm se Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta shqyrtoj me kujdes ankesen tone dhe do ta aprovoj si te bazuar kete ankese duke marre:

Vendim

APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE "Agribau" SHPK kunder Vendimit per shperblim me kontrate te OE „Komtel Project Engineering" SH.P.K. per aktivitetin e prokurimit **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje, 656-22-1432-1-2-1.

***ANULOHET** njoftimi mbi Vendimin e AK-se dates 04.04.2022 per shperblim me kontrate dhe lenda te kthehet ne **Ri-vleresim** dhe te merret nje vendim i drejt ne perputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publik.*

Me respekt
Agribau shpk

SH.P.K. "AGRIBAU" PRISHTINË

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale jan te kosiderueshme ne rast te mos dhenjes se kontrates si ne aspektin finaciare dhe material, fitimin e munguar, shpenzimet pergatitore per kete kontrate etj. Po ashtu duke na eliminuar ne menyren me diskriminuese dhe te padrejt kemi humbje te reputacionit si nje kompani serioze dhe me nje pervoje te gjate ne fushen e furnizimeve te tilla ku edhe do te ndikoj ne zhvillimin e metutjeshem te kompanise sone. Per vleresimin dhe konstatimin e demit real nevojitet nje ekspertize vleresuese-financiare.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Dokumentat shtese te cilat i bashkangjesim kesaj Ankese

1. *Deklarat nenBetim e plotesuar nga Agribau SHPK.*
2. *Deklarat nenBetim e plotesuar nga Comtel Project Engineering SHPK.*
3. *Njoftimin mbi Vendimin e AK-se date 04.04.2022,*
4. *Kerkesa per Rishqyrtim pran AK-se date 06.04.2022,*
5. *Vendimi i AK-se per shqyrtim te kerkeses date 13.04.2022,*
6. *Pergjigja ne Kerkesen per interpretim nga KRPP date 15.04.2022,*
7. *Fletepagesa e ankeses ne OSHP,*
8. *Deshmia e pageses.*